

**KONTRAË
SHITJE KUOTASH**

Në Tiranë, sot në datën 27.07.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), palët e mëposhtme:

SHITËSI:

Walter Alberto TAMBURINI, lindur më 5 qershor 1955 në Castel di Lama (AP), banues në Martinsicuro (TE) në Via Bellini Nr. 4, i.13, me kod fiskal italian TMB LRT 55H05 C093B, mbajtës i kartës italiane të identitetit N. AX 0234026, përfaqësuar nga Z. Emiliano GJIKÀ, shtetas shqiptar, i datëlindjes 25 nëntor 1980, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës shqiptare me Nr. BA3062932, në bazë të prokurës së posaçme noterizuar në Itali me Nr. Repertori 21036 dhe Nr. Koleksioni 12823, regjistruar në Foggia me datë 13.12.2017 me Nr. 6591/1T përpara noterit Fabrizio Pascucci;

BLERËSI:

Kledian MERXHANI, lindur më 25 mars 1982 në Kavajë, shtetas shqiptar me nr. Personal I20325068U.

Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë "BS-ALB" SHPK, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L84023402V ("**Shoqëria**").

Sipas dokumentacionit të depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, kapitali i shoqërisë është ALL 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë Lekë) i zotëruar tërësisht nga Shitësi.

Neni 1

Objekti i kontratës

Shitësi, nëpërmjet kësaj kontrate i shet **Blerësit** kuotën e tij me vlerë sa 100% (njëqind përqind) e kapitalit të Shoqërisë, me vullnet të lirë, të plotë e të pavesuar, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe statutin e Shoqërisë.

Neni 2


Çmimi i shitjes

Duke pasur parasysh raportin aktive/pasive të Shoqërisë, palët bien dakord se çmimi i shitjes së kuotës që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë është EUR 500 (pesëqind Euro), të cilat Blerësi ia ka paguar tashmë Shitësit.

Neni 3

Garancitë

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar i ligjshëm i kuotës që përfaqëson kapitalin që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe se kuota nuk është objekt i ndonjë kontrate premtim shitje dhe është e lirë nga çdo barrë, peng apo pretendim tjetër ligjor të çfarëdo natyre.



Neni 4
Heqje dorë nga të drejtat

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate ai zhvishet nga pronësia dhe të drejtat mbi kuotën që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 5
Të ndryshme


Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi bëhet pronar i 1 (një) kuote që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "BS-ALB" SHPK dhe Shitësi nuk ka asnjë pretendim lidhur me pronësinë apo cdo të drejte tjetër mbi kuotoën në fjalë.

Kjo kontratë u hartua në katër ekzemplarë, me vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe.

Kjo kontratë rregullohet nga legjilacioni shqiptar dhe për çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë kontratë, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.


SHITËSI

Për Walter Alberto TAMBURINI



Emiliano GJIKA

BLERËSI



Kledian MERXHANI